



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Takim i grupit të Deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

Komiteti për marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna

PROCESVERBAL

Tiranë më 14.05.2019, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – nënkryetare e Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Fjala përshëndetëse e zëvendëskryetares së Kuvendit, zonjës Vasilika Hysi.
2. Prezantimi i propozimeve për ndryshime në Kodin Penal nga zoti Altin Hazizaj, drejtor i CRCA-së.
3. Pyetje, përgjigje dhe diskutime rreth propozimeve.
4. Prezantimi i raportit “Fëmijët për të drejtat e fëmijëve”.
5. Diskutime dhe konkluzione.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Enver Roshi, Blerina Gjylamenti, Elena Xhina, Evis Kushi, Almira Xhembulla, Nimet Musaj, Majlinda Halilaj, Ediola Braho.

Të ftuar:

Fëmijët:

Akela Pici - folëse, sekretare e parlamentit rinor, Tiranë,
Kejsi Shehu – folëse, kryetare e parlamentit rinor, Tiranë,
Marsela Delija – folëse, nënkryetare e parlamentit rinor Tiranë,
Alida Zeqiraj, Amadea Jakupi, Arnold Ismailanji, Erti Poka, Enea Dermyshe, Vanesa Mulaj, Marsida Bajrami, Olta Shqau, Rigers Dervishi, Klaudio Prifti.

Shoqëria civile:

Klaudio Pulaha – përfaqësues nga CRCA / ECPAT, Shqipëri

Mirgit Vataj – përfaqësues nga ALO 116 -111, Shqipëri

Linda Pino – përfaqësuese nga Koalicioni për Arsimin në Shqipëri

Anila Meço – përfaqësuese nga *Save the Children*

Altin Hazizaj – përfaqësues nga CRCA / ECPAT, Shqipëri

Rovena Vuksani – përfaqësues nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Matilda Tyli – Ndhmëskomisionere tek Avokati i Popullit

Julian Papaproko – përfaqësues nga *World Vision*, Shqipëri

Kleopatra Gjina – përfaqësuese nga Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Mersila Ballo – përfaqësuese nga UNICEF-i

Institucione:

Alma Tandili –Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve

Nejla Peka Osmani – komisionere pranë Avokatit të Popullit

Matilda Tyli – ndihmëskomisionere për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë
Avokatit të Popullit

Iva Zajmi – përfaqësuese e UNICEF-it

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi - Përshëndetje, të rinj dhe të reja!

Të nderuar kolegë dhe kolege, përfaqësues të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive shtetërore!

Unë quhem Vasilika Hysi. Jam anëtare në Komisionin e Ligjeve, zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë dhe zëvendëskryetare e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Jam këtu bashkë me kolegun Enver Roshi, i cili është kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe nënkryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”.

Grupi i deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” ka pesë komitete, por ky është një takim midis dy komiteteve, Komitetit për Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile dhe Komitetit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna.

Në këtë takim do të diskutojmë dy çështje. Së pari, do të dëgjojmë disa propozime të organizatës CRCA për ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me fëmijët, pasi ndryshimet e tjera të Kodit Penal do të bëhen në një seancë dëgjimore që do të bëjë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Pika e dytë e rendit të ditës është prezantimi i raportit “Fëmijët për të Drejtat e Fëmijëve”, që do të paraqitet nga vetë fëmijët.

Dua t’u bëj me dije të gjithë fëmijëve të pranishëm këtu se Kuvendi i Shqipërisë i ka dyert e hapura për të gjithë fëmijët. Vitin e kaluar ne kemi pritur në Kuvendin e Shqipërisë 12700 fëmijë, të grupeve të ndryshme sociale, nga e gjithë Shqipëria, duke filluar nga fëmijët jetimë, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijët e komuniteteve rom dhe egjiptian, grupime të fëmijëve që janë shumë të fokusuar në të drejtat e fëmijëve, sikurse jeni edhe ju.

Këtu janë të pranishëm shumë deputetë të forcave politike të ndryshme, por, pavarësisht bindjeve politike, për fëmijët ne jemi të gjithë miq dhe nuk i shikojmë çështjet e të drejtave të fëmijëve me ngjyra partiake, sikurse ju shpesh mund të dëgjoni dhe shikoni në rrjetet sociale. Këtu ka deputetë që kanë punuar me fëmijët, që kanë formime të ndryshme dhe janë të profesioneve të ndryshme, por të jeni të bindur që të gjithë janë shumë të vëmendshëm dhe do ju dëgjojnë me vëmendje për të gjitha shqetësimet ose rekomandimet që ju do të adresoni.

Pas kësaj seance dëgjimore, ne kemi si rregull, në bazë të procedurës që ka Kuvendi, të informojmë edhe deputetët e tjerë që nuk janë pjesë e komiteteve që bëjnë sot këtë takim, si dhe komisionet e përhershme parlamentare, në varësi të problemeve që ju do të ngrini në raportin tuaj. Njëkohësisht, dua të theksoj që ju keni të drejtën të dëgjoheni për çështjet specifike në komisionet e përhershme parlamentare.

Gjithashtu, ne kemi ftuar edhe një deputet, i cili është pjesë e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”, por është edhe kryetar i delegacionit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, zotin Ervin Bushati. Është një koleg shumë i vëmendshëm ndaj çështjeve që lidhen me të drejtat e njeriut, por transmeton edhe rekomandimet ose shqetësimet që fëmijët në përgjithësi kanë dhe veçanërisht fëmijët e vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Mos harroni që ne kemi ratifikuar shumë konventa për mbrojtjen e të drejtave tuaja, kështu që kemi përgjegjësinë që jo vetëm të bëjmë ligje të mira, por edhe të monitorojmë zbatimin e tyre.

Po ia kaloj fjalën zotit Altin Hazizaj për të prezantuar rekomandimet që ka për Kodin Penal. Mos harroni se është nismë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Meqenëse jemi mbledhur për fëmijët dhe me deputetët që janë pjesë e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” do t’ju lutesha të fokusoheshit vetëm te nenet që bëjnë fjalë për mbrojtjen e fëmijëve.

Faleminderit!

Altin Hazizaj – E nderuar zonja Hysi,

Së pari, më lejoni të falënderoj në mënyrë të posaçme grupin parlamentar “Miqtë e Fëmijëve” për dedikimin dhe për kujdesin në drejtim të nismave ligjore që ka ndërmarrë gjatë 3 vjetëve të fundit!

Gjithashtu, dua të falënderoj në mënyrë të posaçme një pjesë të anëtarëve të Komisionit të Ligjeve dhe në mënyrë të veçantë nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut për bashkëpunimin e gjatë dhe produktiv që kemi pasur prej vitesh.

Për shkak të bashkëpunimit Kuvend - shoqëri civile, ne sot kemi ligje më të mira, që u përgjigjen nevojave të qytetarëve për mbrojtje nga dhuna, për shërbim ligjor falas, mbrojtje nga diskriminimi, mbrojtje të të drejtat e fëmijëve apo edhe mbrojtje të të miturve gjatë procesit penal.

Sot po shqyrtojmë dhe diskutojmë disa nene të Kodit Penal të Shqipërisë.

Komisioni i Ligjeve dhe CRCA/ECPAT – Shqipëri kanë tashmë një histori të provuar të bashkëpunimit, falë të cilit sot në Kodin Penal është bërë e mundur mbrojtja e fëmijëve nga shitja, nga dhuna në familje, pornografia dhe nga dhuna në institucione. Megjithatë, kjo nuk mjafton.

Zhvillimet më të fundit dhe përhapja e shpejtë e teknologjisë së informacionit, shpenzimi i një kohe gjithnjë e më të lartë në internet e kanë kthyer navigimin *online* në një fushë të minuar. Përpos të mirave, shpejtësisë së informacionit dhe komunikimit, ne të gjithë po përballemi gjithnjë e më shumë me rreziqe të mëdha *online*, duke filluar nga më i thjeshti,

që mund të jetë vjedhja e identitetit virtual, deri te dhuna apo edhe ngacmimet seksuale të fëmijëve nga grabitqarët seksualë.

Raporti “Krime pa ndëshkim”, i cili besoj se është shpërndarë tek të gjithë anëtarët e GPMF-së, ndërsa zyrtarisht juve ju është shpërndarë në shkurt të këtij viti, tregon edhe një herë se krime monstruoze po kryhen ndaj fëmijëve dhe të rinjve në internet, madje, për shkak të mungesës së rregullimeve në Kodin Penal, këto krime mbeten të pandëshkuara edhe sot e kësaj dite.

Jo më larg se një javë, Policia e Shtetit na njoftoi për një rast bulizmi *online*, që kishte shkaktuar tentativë për vetëvrasjen e një të mituri.

Tri ditë më parë, rrjetet sociale u bombarduan masivisht *online* me profilin e një grabitqari seksual, i cili kryente marrëdhënie seksuale ndërmjet një të rrituri dhe një të mituri. Askujt nuk i shkoi në mendje që po shpërndanin pornografi me të mitur, më keq akoma që vajza në video mund të ishte fëmija e kujtdo nga ne.

Sot grabitqarët seksualë po i kërkojnë dhe po i gjejnë viktimat e tyre gjithnjë e më shumë në internet.

Raporti i Departamentit të Shtetit për trafikimin e qenieve njerëzore, raporti i EUPR-it të CRCA/ECPAT-it Shqipëri, raporti i Europolit i vitit të kaluar për trafikimin e qenieve njerëzore tregojnë se krimet më të rënda ndaj fëmijëve po kryhen fillimisht në internet, por më pas ato mund të kalojnë edhe në jetën reale.

Gjuha e urrejtjes, vjedhja e identitetit, mesazhet me natyrë seksuale, pornografia *online* e fëmijëve, dhuna seksuale janë kthyer sot në makthin e fëmijëve dhe familjeve në Shqipëri. Ndaj sot është koha që t’u themi “Jo” të gjitha këtyre krimeve.

Organizata CRCA/ECPAT – Shqipëri në vitin 2016 ngriti platformën kombëtare për internet të sigurt. Falë kësaj platforme, në bashkëpunim edhe me ministritë kyçe të qeverisë shqiptare, ne ndjekim çdo denoncim që vjen nga fëmijët dhe të rinjtë.

Po në këtë kuadër, që nga viti 2016 ne kemi organizuar tri tryeza të mëdha konsultuese me ekspertë nga të gjitha fushat e së drejtës, sigurisht edhe për mbrojtjen e fëmijëve, nga Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes Sociale në atë kohë (sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), Prokuroria e Tiranës, si dhe qindra organizata të shoqërisë civile, për të diskutuar së bashku ndërhyrjet që sot, le të themi zyrtarisht, po i prezantojmë në Kodin Penal, për t’i paraqitur më pas për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara, që sot vijnë para jush, janë tepër të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve gjatë navigimit të tyre në internet. Mosmiratimi i tyre

do të thotë që ne do të pranojmë se krimet kundër fëmijëve do të vazhdojnë të mos ndëshkohen dhe që grabitqarët seksualë do të vazhdojnë të prodhojnë viktime.

Në tërësi ne propozojmë shtatë shtesa të reja në Kodin Penal dhe 12 përmirësime të neneve ekzistuese. Në këtë kuadër, meqenëse jemi edhe në javën ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë, kemi propozuar, ndër të tjera, edhe eliminimin e gjuhës diskriminuese, që përmban Kodi Penal përkundrejt komunitetit LGBTI në Shqipëri.

E fundit, që mendoj se është edhe gjëja më e rëndësishme, të gjitha shtesat dhe ndryshimet e propozuara vijnë si pasojë e rekomandimeve dhe kërkesave të dala nga direktiva 92/2011 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian, datë 13.12.2011 “Për luftën kundër abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual dhe pornografisë së fëmijëve”, e cila zëvendësoi vendimin kuadër të Këshillit Europian 004/68/JHA, gjë, që, në fakt, e sjell Kodin Penal në linjë dhe në përputhje të plotë me *Acquis Communautaire*, që është tepër e rëndësishme për legjislacionin.

Për sa u përket ndryshimeve të propozuara, dua të ndalem te dy-tri më të rëndësishmet.

E para, ne propozojmë një ndryshim të përkufizimit të marrëdhënies seksuale me fëmijën, pra duke dhënë një përkufizim të saktë se çfarë konsiderohet marrëdhënie seksuale me fëmijën ose dhunë seksuale ndaj fëmijës. Kodi Penal, në fakt, dhunën seksuale ndaj fëmijës e përkufizon si marrëdhënie seksuale me fëmijën.

E dyta, që është tepër e rëndësishme dhe që mungon në Kodin Penal, është shtyrja e fëmijës për të kryer, ose për të hyrë në marrëdhënie seksuale. Kjo në gjuhën angleze njihet me termin “*grooming*”, pra një i rritur e përgatit fëmijën të hyjë në një marrëdhënie seksuale, ku fëmija duket sikur ka hyrë me dëshirën e tij në këtë marrëdhënie. Por, në fakt, është i rrituri që e ka përgatitur fëmijën për të hyrë në këtë marrëdhënie. Po ashtu, kemi komunikimin me fëmijën për qëllime seksuale ose, siç njihet në gjuhën angleze me termin “*sexting*”, çka nënkupton të gjitha mesazhet me natyrë seksuale.

Për më tepër, se, duke i prezantuar, në fakt, m’u kujtua edhe Konventa e Lanzarotit, të cilën e kemi përmendur edhe në tekstin e relacionit të ligjit, të gjitha propozimet vijnë edhe në mbështetje të kësaj konvente, siç mund ta thotë edhe Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Shqipëria ka raportuar për Konventën e Lanzarotit gjatë vitit të kaluar, por nuk është vlerësuar pozitivisht, pasi nuk bën një ndarje të drejtë ndërmjet asaj që mund të konsiderohet shkëmbim i imazheve ndërmjet vetë fëmijëve, pra me dëshirën e tyre (kjo është pjesë e rritjes dhe pjekurisë seksuale të vetë fëmijëve dhe ka shpjegime psikologjike pse ndodh e të tjerë) dhe të rriturve.

Të gjitha ndryshimet në Kodin Penal bëjnë të qartë, por edhe fusin nocionin e personit që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale. Pra, një person që nuk e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, që përgjithësisht është mosha nën 14 vjeç, nuk mund të dënohet për një vepër, le të themi, kur komunikimi kryhet ndërmjet vetë fëmijëve, kuptohet, me dëshirë dhe jo e kundërta.

Njëkohësisht, ne kemi parë edhe disa nene të tjera, siç mund të jetë neni 108/a “Ngacmimi seksual”, për të cilin kemi kërkuar një riperifrazim. Në fakt, ne kërkojmë një rishikim të plotë të nenit 117 “Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve nga pornografia”. Neni 117 është ndryshuar dy herë, në fakt.

Ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë ndërmjet Ministrisë së Brendshme, në atë kohë zëvendësministre ka qenë zonja Zajmi, dhe CRCA/ECPAT Shqipëri për ta sjellë nenin në fjalë në përputhje të plotë me legjislacionin ndërkombëtar. Pavarësisht se kemi bërë ndryshime në këtë nen edhe në fundin e vitit 2013, përsëri neni nuk ka qenë në përputhje të plotë me legjislacionin ndërkombëtar. Prandaj kemi propozuar një riperifrazim të të gjithë nenit. Nga ana tjetër, futet nocioni i pengimit dhe shkeljes së fshehtësisë së korrespondencës dhe të komunikimit, duke përfshirë edhe komunikimet *online*. Kjo, sidomos për aksesin, vjedhjen, hakërrimin e mesazheve *online*, që mund t'i ndodhë çdo personi.

Po ashtu, neni 123/a që flet për përdorimin e paautorizuar dhe vjedhjen e identitetit, është kërkuar për t'u përfshirë në Kodin Penal. Ndër të tjera është dhe ajo që quhet profili dixhital ose profili *online*.

Ndër të tjera, nisur edhe nga gjetjet e raportit të krimit pa ndëshkim, ne kemi propozuar edhe ndryshimin tërësor dhe përshtatjen e nenit 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik”. Këtu të shtohet: “diskriminuese, paragjyquese, denigruese ose ksenofobie (që është në nenin ekzistues), nëpërmjet sistemit kompjuterik ose programeve kompjuterike”. Kjo bëhet për të parandaluar të gjithë gjuhën e urrejtjes, që ndodh në internet.

E njëjta gjë propozohet edhe për nenin 119/b, edhe për nenin 265, “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, që ka të bëjë më shumë me rastin kur personat apo grupet specifike atakojnë dhe nxisin urrejtjen ndaj tyre. Në këtë kuadër, ne kërkojmë që pjesë e mbrojtjes që neni aktual 265 jep për krimin e urrejtjes, të shtohet edhe: identiteti gjinor, aftësia e kufizuar, mosha (duke pasur parasysh fëmijët), gjinia, përkatësia sociale, ose shoqërizimi me një grup të caktuar. Për më shumë, është parë se gjuha e urrejtjes ndodh jo vetëm në jetën reale nëpërmjet botimeve, si gazetatat, televizionet etj., por edhe nëpërmjet internetit dhe mjeteve të tjera të komunikimit social.

Të tjerat janë të gjitha në dosje dhe unë nuk po hyj më në detaje. Këto janë 7 nenet, që ne kërkojmë të kenë ndryshime tërësore.

Siç e thashë edhe më parë, të gjitha janë konsultuar jo vetëm me shoqërinë civile, por edhe me të gjitha institucionet shqiptare përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Hazizaj!

Kush nga kolegët ka pyetje, lidhur me nismën që propozon CRCA-ja?

Nëse ka pyetje, besoj se Komisioni i Ligjeve kur të fillojë procedurën e shqyrtimit parlamentar të nismës së deputetëve për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, do të zhvillojë seanca dëgjimore, siç po bëjnë ministrinë përkatëse për kapitujt apo nenet, që lidhen me fushën e tyre.

Sikurse e dini, në paketën e depozituar nuk ka dispozita që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe kjo është arsyeja që Altini ka kërkuar të dëgjohet te grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, për të qenë sa më sensitivë ne, deputetët, që do të mbështesim këtë debat në Komisionin e Ligjeve.

Fjalën e ka zoti Bushati!

Ervin Bushati - Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, si prindër, por edhe si ligjvënës jemi shumëfish më të predispozuar për të qenë përgjegjës dhe për të marrë përsipër një iniciativë të tillë. Pikërisht, prandaj janë të rëndësishme ndërhyrjet në Kodin Penal, sepse ato bëhen rrallë dhe duhet të jenë të sakta. Patjetër, ato duhet të jenë në progres me teknologjinë, me përafrimin që ne kemi në marrëdhëniet tona njerëzore. Që të mos ndërhyhet shumë shpesh patjetër, duhet ditur se çfarë targetojmë, çfarë duam të arrijmë.

Pyetja ime është: Cila nga eksperiencat apo nga kodet penale të Europës është marrë si shembull? Ne sapo i morëm dhe na duhet kohë që të njihemi më shumë, por unë desha të di se kush janë eksperiencat kryesore që janë marrë si shembull? Cili shtet është marrë si shembull? Edhe sot në Europë ky është një *moving target*, është në lëvizje, sepse teknologjia avancohet, marrëdhëniet njerëzore avancohet dhe shoqëria avancohet shumë, duke pasur parasysh edhe presionet demografike, emigracionin, teknologjinë apo edhe edukimin sot në botë.

Faleminderit!

Altin Hazizaj – Në fakt, gjatë shqyrtimit janë marrë në konsideratë disa kode dhe disa nisma penale.

E para, vetë BE-ja ka një përmbledhje (jo të të gjitha kodeve penale, sepse kjo përmbledhje do të ishte super masive), por të të gjitha legjislacioneve të vendeve, në lidhje me direktivën 2011/92 të BE-së. Meqenëse kjo direktivë është e detyrueshme për të 28 shtetet anëtare të BE-së, ata kanë një përmbledhje të përputhshmërisë së legjislacionit. Bazuar te ky dokument i BE-së, ne kemi ndërtuar të gjithë përpjekjen tonë për ndërhyrje.

E dyta, është shikuar në detaje Kodi Penal bullgar, sepse Bullgaria ka qenë shteti i fundit që ka pasur probleme të përputhshmërisë së legjislacionit me direktivën e BE-së. Është parë Kodi Penal kroat për disa rregullime të reja, që ata sapo kishin bërë për *grooming*

Njëkohësisht, kemi dy eksperiencia që mëdha, që vijnë nga Britania dhe nga SHBA-ja, të cilat kanë një legjislacion të ndryshëm nga Shqipëria, sepse kjo ka të bëjë me sistemin e tyre ligjor.

Në nivelin rajonal është parë kryesisht Bullgaria si një shembull, që më së fundi arriti të përputhë legjislacionin e vet me direktivën e BE-së.

Këto kanë qenë më kryesoret.

Vasilika Hysi - U sqaruar zoti Bushati?

Faleminderit, zoti Hazizaj!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Blerina Gjylameti.

Blerina Gjylameti - Faleminderit, zëvendëskryetare!

Faleminderit, zoti Hazizaj për nismën dhe për punën e bërë ndër vite edhe në mbështetje të të drejtave të fëmijëve, por jo vetëm!

Pyetja ime ka të bëjë me pjesën teknike. Shoh që ka disa propozime për ndryshime dhe ajo që më bie më shumë në sy te këto ndryshime, është se ka propozime për eliminimin ose heqjen e termit “homoseksuale”. Po të shohim që nga neni 100 e në vijim, ka një ndryshim të terminologjisë dhe eliminim të këtij termi.

Unë kam një pyetje: çfarë ju ka shtyrë që të bëni këtë ndryshim dhe çfarë pritet në thelb?

Një element që përsëri më bën të mendoj, është fakti për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga pornografia apo nga pjesa e përdorimit të internetit tashmë, jam dakord të kemi një ashpërsim të dënimeve apo të masave që merren, por sa mundet të implementohen këto në realitet? Pra, sa e kanë të mundur sot strukturat shtetërore që ta monitorojmë, sepse eksperiencia ka treguar se nga ana e ligjeve, hartimit të tyre, parashikimit të veprave penale, apo masave që duhen marrë kemi një legjislacion relativisht të kënaqshëm, por implementimi është gjithmonë ajo pjesë që kemi pasur probleme, më pas monitorimi.

Pyetja ime është: sa munden realisht strukturat shtetërore të jenë efeciente edhe me këto ndryshime ligjore që ne mund të ndërmarrim duke ju dëgjuar ju dhe më pas duke i diskutuar në komisionet përkatëse.

Faleminderit!

Vasilika Hysi –Faleminderit, zonja Gjylameti!

Po, zoti Hazizaj.

Altin Hazizaj – Për sa i përket kërkesës për eliminimin e termit “homoseksual\homoseksuale”, ka rekomandime si nga KE-ja, në raporte të posaçme që kanë bërë për situatën e të drejtave të komunitetit LGBT-i në Shqipëri, ashtu edhe nga OKB-ja për eliminimin e termave, të cilët nuk përdoren për të ndëshkuar një vepër specifike në mënyrë të ndryshme nga pjesa tjetër. Nëse ne do të shohim të gjitha nenet, ku përmendet termi homoseksual apo homoseksuale, termi nuk përdoret për të bërë diferencën dhe për të ndëshkuar në mënyrë të ndryshme një akt specifik, por bëhet për të treguar në mënyrë paragjyquese dhe diskriminuese një komunitet të caktuar. Në këtë aspekt, të gjitha rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, nga të cilat ne monitorohemi dhe raportojmë, e shikojnë dhe e kanë gjetur Kodin Penal jo në përputhje me standardet e kërkuara.

Së dyti, cila është diferenca midis përdhunimit të një të mituri dhe përdhunimit të një të rrituri?! Të dyja janë dhunë seksuale, diferencë bën vetëm marrëdhënia nëpërmjet vaginës dhe anusit. A do të bëjnë diferencë në Kod që do të ndëshkojnë marrëdhënien nëpërmjet anusit apo vaginës në mënyrë më specifike? Në qoftë se nuk kemi diferencë në nene për sa i përket kësaj lloji marrëdhënieje, duke presupuzuar se pasoja që ajo shkakton është më e rëndë, më e lehtë dhe që mund të dënohet më shumë ose më pak, por dhuna është dhunë dhe duhet ndëshkuar, nuk ka rëndësi nëse kryhet nga një burrë apo një grua nëpërmjet anusit. Ne nuk bëjmë as diferencën nëse ajo bëhet nëpërmjet mjeteve të tjera, sepse në fund të ditës prapë është dhunë seksuale. Dhuna seksuale është onda e fëmijëve dhe duhet ndëshkuar në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe pa paragjykim, ndaj një të mituri, sepse aty ka formimin e të miturit, që është element i konsiderueshëm dhe psikologët e konsiderojnë, ose nëpërmjet të rriturve. Është marrëdhënie homoseksuale apo marrëdhënie midis dy sekseve të kundërta, nuk e ndryshon fare. Kjo është në aspektin më social dhe psikologjik të çështjes.

Blerina Gjylameti – Strukturat shtetërore me kapacitetet që kanë aktualisht a kanë mundësi që këto ndryshime që ne bëjmë t’i implementojnë dhe t’i monitorojnë, e kam fjalën për pjesën e pornografisë dhe nenet që kanë të bëjnë me të?

Altin Hazizaj – Të falënderoj për pyetjen, sepse është shumë interesante!

Sot Policia e Shtetit ka marrëdhënie të formëzuara me institucione ose biznese globale, siç është facebook, google, e njëjta gjë vlen edhe për organizatën tonë në Shqipëri. Ne kemi marrëdhënie formale me facebook-un për momentin, jemi duke negociuar me google-in, meqenëse është përgjegjës për sa i përket youtube-it dhe sot kemi lidhur një mini marrëveshje me amazon.com, për shkak se ata kanë teknologjitë e avancuara të inteligjencës artificiale. Ajo që vlen të theksohet është me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, unë do të doja që ata ishin sot këtu, ne kemi një bashkëpunim të shkëlqyer për të gjitha rastet. Vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është duke organizuar të gjithë sektorin e krimin kibernetik. Kjo është një kërkesë e vjetër jona, ne kemi pasur takime dhe na janë shprehur se sapo kanë filluar me riorganizimin.

E dyta, duke qenë se policia shqiptare është pjesë aktive e Interpolit, e Europolit, pa diskutim që zbaton të njëjtat standarde, se është e detyruar, lidhur me këtë aspekt.

E treta, që besoj se është më e rëndësishmja dhe që i jep përgjigje finale pyetjes, është vetë institucioni i Policisë së Shtetit, i cili i ka kërkuar dhe i ka rekomanduar këto ndryshime në Kodin Penal. Ashtu siç e thashë, ndryshimet tona vijnë të konsultuara. Në qoftë se ka qenë një institucion, i cili i ka kërkuar me më shumë forcë se të gjitha të tjerat këto shtesa në Kodin Penal, është institucioni i Policisë së Shtetit. Mos e merrni për bazë fjalën time, por bisedoni me kolegët e Policisë së Shtetit. Siç ju thashë, kjo është një nismë e përbashkët dhe ne si shoqëri civile dhe ata si institucion shtetëror do të ishim më se të lumtur nëse këto ndryshime do të miratoheshin.

Blerina Gjylameti – Kam edhe diçka tjetër. Shoh një specifikim në disa nene: “personi që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale”. Përse duhet ky lloj specifikimi, për sa kohë e kemi shumë të qartë në Kodin Penal se kur ngarkohet me përgjegjësi një person në momentin kur kryen një vepër të caktuar?

Ju faleminderit!

Altin Hazizaj – Në fakt, kjo kërkesë është shtuar në një moment të tretë dhe vjen nga Konventa e Lanzarotit, e cila kërkon të bëhen disa diferenca ndërmjet imazheve të vetëprodhuara, të cilat i gjeneroj unë si individ; imazheve të vetëprodhuara nga fëmijët që shkëmbehen ndërmjet tyre, të cilat nuk kanë përgjegjësi penale dhe imazheve të prodhuara nga të rriturit, të cilat u dërgohen fëmijëve. Në këtë aspekt, rekomandimi i Konventës së Lanzarotit (ky është një aspekt shumë teknik i ndërhyrjes në ligj dhe mund të gjejmë një teknikë të caktuar legislative, që ta përmendim vetëm një herë) është që në marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve dhe adoleshentëve, për aq kohë sa ekziston konsensusi që ne të dyja palët shkëmbejmë me dëshirën tonë imazhet tona, pra që i kemi gjeneruar ne dhe që nuk përbëjnë

pornografi të fëmijëve, atëherë këto nuk do të konsiderohen pornografi e fëmijëve, por do të konsiderohen si imazhe të vetëprodhuara nga fëmija për një fëmijë tjetër. Në momentin kur imazhi i dërgohet një të rrituri, atëherë aty ka disa komplikime ligjore, dhe kjo është arsyeja pse përkufizohet në nen: “Personi që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale”. Me teknike legjislative mund të gjendet edhe një zgjidhje tjetër.

Vasilika Hysi – Po, urdhëroni!

Ju lutem, prezantohuni, sepse takimi po regjistrohet!

Mirgjit Vataj – Faleminderit!

Jam Mirgjit Vataj, nga linja e këshillimit për fëmijë “Alo 116”. Faktikisht, ndoshta Altinit i shpëtoi, është një detaj tejet teknik, që lidhet me ndryshimet që janë propozuar. Duke qenë se ne vijmë nga një shërbim që nga viti 2009, ku në fokus kemi pasur raportimin e rasteve të dhunës që ndodh në internet, janë 3 ndryshime, të cilat do të na i lehtësonin punën, duke qenë se bashkëpunojmë me policinë, pra janë nenet 123 dhe 119, germa “a” dhe “b”. Këto ndryshime vijnë bazuar edhe në precedentë, pra nuk vijnë vetëm nga nevoja për të përafuar legjislacionin me direktivat e Bashkimit Europian, por lidhen edhe me natyrën e raportimeve dhe me vështirësitë që ne kemi ndeshur bashkë me policinë për të trajtuar rastet që janë raportuar. Kështu, pothuajse minimumi një herë në dy ditë, ne marrim të dhëna dhe raportohen raste që kanë të bëjnë me denigrimin e figurës në *Youtube*. Çështja nuk është vetëm për t’i mbyllur, por të paktën të evidentohen personat, të cilët i hedhin këto materiale, që denigrojnë figurën e fëmijëve. Problemi i policisë ka qenë mospërshtatja ose mangësitë që ka pasur korniza ligjore e Kodit Penal për të reflektuar dhe për të iniciuar hetime apo procedime për të zbuluar personat, ku hidhen këto materiale. Besoj se edhe reflektimi, qoftë në nenin 119 që është për ne është një pikë shumë e rëndësishme duke parë volumin, duke parë edhe pasojën që shumë fëmijë, për të cilët na janë raportuar rastet e kësaj natyre, nuk shkojnë as në shkollë. Aktualisht, po trajtojmë edhe raste me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila ka të bëjë me denigrimin e fëmijëve në internet. Besoj se është shumë e rëndësishme që këto reflektime të miratohen. Gjithsesi, do t’i vijë radha për t’u diskutuar në komision edhe në nivelin teknik.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Fjalën e ka deputetja Xhina.

Elena Xhina - Faleminderit, zonja Hysi!

Ju falënderoj për prezantimin!

Te propozimi juaj vihet re se janë shtuar dy figura të reja veprës penale, me sa konstatoj janë nenet 100/a dhe 100/b, ku flitet për shtyrjen e fëmijës dhe komunikimi me fëmijën për qëllime seksuale.

Pyetja ime: për sa kohë që këto dy figura të veprës penale nuk kanë ekzistuar deri tani në Kodin Penal, a kenë konstatuar që këto raste kanë qenë të pandëshkuara? Pra, është bërë një studim dhe ka rezultuar se këto raste janë të pandëshkuara?

Faleminderit!

Altin Hazizaj – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, ne me grupin parlamentar “Miqte e fëmijëve” në shkurt kemi shpërndarë raportin e parë kombëtar për sigurinë e fëmijëve në internet. Nuk e di nëse është në dosje, por mund t’jua sjellim një nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, është edhe *online*.

Unë do të kaloj vetëm te disa të dhëna kryesore, të cilat kanë dalë nga raporti dhe pse kemi arritur në këto konkluzione.

Së pari, që nga viti 2016 e deri më sot janë mbi 200 e ca raste të fëmijëve dhe të adoleshenteve, që raportojnë te platforma kombëtare *ISIGURT.AL*.

Së dyti, të gjitha këto lloj krimesh janë të pandëshkuara, pothuajse prekin në mënyrë të njëjtë, si djemtë ashtu edhe vajzat: 46% janë djem dhe 43% janë vajza nga të gjitha raportimet.

Për sa i përket grupmoshës më të prekur, fillon nga mosha 11 vjeç dhe deri në moshën 80 vjeç, plus që është grupmosha e tretë. Grupmosha më e prekur, nga të gjitha raportimet që kemi ne është 15-17 vjeç.

Për sa i përket vendbanimit të fëmijëve dhe të rinjve, janë të gjitha qytetet. Kuptohet Tirana mban peshën kryesore, megjithatë shikojmë disa anomali. Në fund të vitit 2018 Peshkopia dilte qyteti i katërt në Shqipëri, pavarësisht numrit të popullsisë që është tepër i ulët, krahasuar me qendrat e mëdha të banuara. Domethënë, rreziku i krimeve *online* nuk është vetëm dëmi që mund t’i bëjnë një personi të vetëm, pra bulizmi, vjedhja e identitetit e të tjera. Në qytete më të vogla ne shikojmë edhe ato që quhen grupe të organizuara të adoleshentëve ose të rinjve, që përndjekin në mënyrë të posaçme vajzat *online*. Kuptohet që mbase mund të kenë probleme të komunikimit direkt me vajzat. Në qoftë se një herë edhe një kohë grabitqarët seksualë i gjuanin fëmijët drejtpërsëdrejti te gjimnazi, te shkolla, tani e kanë kthyer në një luftë *online* ose në një grabitje *online*.

Unë nuk dua t'i përfshijë fëmijët sot, sepse kemi shumë adoleshentë këtu. Jam i sigurt se në qoftë se në një moment tjetër do t'i pyesni vetë adoleshentët, do t'ju tregojnë raste të frikshme të ngacmimeve dhe dhunës seksuale në internet.

Po ashtu, një çështje tjetër është gjuha e urrejtjes dhe këtu hyn bulizmi në të gjitha format e tij. 62% e rasteve që kanë ardhur në *ISIGURT.AL*, janë të lidhura me gjuhën e urrejtjes ndaj fëmijëve. Kjo zhvillohet sidomos në *Youtube* ose në *Instagram*. Pastaj kemi adresa fallco, përndjekje pornografi, postime të papërshtatshme; tek postimet e papërshtatshme ne fusim seksin, që janë mesazhet e papërshtatshme me natyrë seksuale.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

A keni pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Zajmi!

Iva Zajmi –Duke e lavdëruar nismën dhe përshtatshmërinë e kohës në të cilën ajo ndërmerret, kam merak se nisma duhet t'i përgjigjet siç duhet të gjitha nevojave që ne kërkojmë të plotësojmë, pasi, ashtu siç u tha këtu, Kodi Penal është një ligj i posaçëm dhe nuk preket shpesh. Kështu që, meqëqëse preket, të jemi të sigurt që po bëjmë ndërhyrjen e duhur.

Unë i pashë ndryshimet dhe mendja më shkoi te dy raste të fundit, të paktën të raportuara në media shumë gjerë, që janë të njohura edhe për publikun, pra që kanë të bëjnë me elemente që ju keni paraqitur; rasti i Kavajës dhe i Beratit. Çfarë i bashkon këto raste?! I bashkon fakti se nuk kemi të bëjmë me të huaj, por kemi të bëjmë me të dhëna të poseduara nga ish i dashuri i vajzës, për shkak të marrëdhënies së tyre të afërt, që bëhen elementë ose bëhen burim kërcënimi për ta detyruar të kryejë marrëdhënie seksuale me të njëjtin person ose me të tjerë jashtë dëshirës së saj, për ta nënshtruar ose për ta turpëruar në forma të ndryshme. Pra, në këtë rast agresori nuk është i rritur, është minoreni, ka të njëjtën moshë me vajzën dhe të dhënat në momentin që janë marrë, janë marrë për shkak të intimitetit që kanë pasur, pra as janë vjedhur, as janë piratuar apo të jetë përdorur *Facebook-u*. Domethënë, kjo është një portë e hapur rreziku. Me aq sa pashë, është neni 119/a që flet për këtë, por, a ka nevojë që të bëhet rregullim dhe formulim, sepse e kuptoj që ndryshimet janë bërë në një kohë ndoshta më shpejt, që të përfshihen edhe këto lloj rreziqesh. Nuk e di si mund të jetë politika penale në rastet e shkelësve minoreni, që janë në ish-marrëdhënie besimi me viktimën.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Zajmi!

T'i bëj edhe unë pyetjet?

Një pyetje ishte ajo që e adresoi edhe Iva. Unë e kam shqetësim këtë. Më bëri pak përshtypje fjala që thatë kur deputetja Gjylameti ju pyeti se pse e keni shtuar togfjalëshin “personi që ka përgjegjësi penale” dhe dalluat se në rastet kur fëmijët shkëmbejnë foto, qoftë edhe intime me njëri-tjetrin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të tyret.

...atëherë kjo nuk do të quhet vepër penale. Dakord, ju e dini që lidhjet tani janë më të hershme dhe shumica e fëmijëve (kur them fëmijë e kam fjalën për ata nën moshën 18 vjeç) i kanë shkëmbyer fotot në mirëbesim me njëri-tjetrin, kanë qenë në marrëdhënie shumë të mira dhe, një ditë të bukur, shikojnë videon intime, që bën xhiro nëpër rrjetet sociale, për shkak të një kapriçoje, zënke, xhelozie e të tjera.

Në këtë kuadër, më duket sikur kategorinë e personave 14-18 vjeç, që janë autorë të veprave penale, ju i lini të pambrojtur dhe Kodi Penal dobësohet këtu. Kjo është e para.

E dyta, më shqetëson rishikimi që i keni bërë nenit 124, keqtrajtimit të fëmijës, dispozita ku kolegja jonë, zonja Bregu, ka ndërhyrë disa herë për ta ndryshuar.

Ju keni shtuar një paragraf, ku thoni: “Denigrimi shoqëror i fëmijës, bulizimi”. Jam shumë dakord. Bulizmi është problem shumë i madh. Ne kemi kaq kohë që flasim për të pasur një ligj jopenal për parandalimin e bulizmit, për të filluar një fushatë kombëtare dhe për t’i thënë të gjithë bashkë stop bulizimit.

Si do ta vërtetosh penalisht denigrimin shoqëror (po flasim këtu si juristë penalistë), që personi të ketë përgjegjësi penale?

Pse pikërisht e ndëshkoni penalisht dhe nuk vini me nismën, që e kemi diskutuar kohë më parë, për të pasur një ligj për bulizimin dhe, mbi të gjitha, një fushatë të gjerë sensibilizuese?

Së treti, ju ashpëroni shumë dënimet penale dhe vë re që në shumë vepra penale të krimeve seksuale, të marrëdhënieve seksuale, shtohet dënimi.

Nga ana tjetër, aty-këtu shoh që kategori të posaçme të të miturve lehtësohen, për shembull, të miturat që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale ju i përjashtoni. Nuk e di arsyen, ndoshta mendoni se mosha 14 vjeç u jep informacion të njëjtë personave.

Keni ndërhyrë edhe në disa nene të tjera, duke përdorur shprehjet “marrëdhënie me kërcënim”, “marrëdhënie me mashtrim”.

A keni gjetur në praktikën tuaj raste që marrëdhëniet me mashtrim ose me kërcënim nuk janë ndëshkuar? Ndërkohë, kërcënimi dhe mashtrimi janë vepra që bashkëkonkurrojnë

dhe dënimin e kanë shumë më të rëndë ose shpesh janë rrethanë rënduese, kur përdoret mirëbesimi i fëmijës.

Së fundi, Mirgiti tha se ndëshkimi i përdorimit të paautorizuar dhe vjedhja e identitetit ka dalë si problem me policinë. Jam shumë dakord, por kjo nuk duhet të lidhet vetëm me mungesën e trajnimeve të mjaftueshme të policisë, sepse duke shkuar e penalizuar çdo gjë në Kodin Penal, harrojmë që seksioni i krimit kibernetik i ka të gjitha mekanizmat dhe instrumentet për t'i parandaluar dhe ndëshkuar këto vepra penale dhe ne mund të parandalojmë shumë prej tyre.

Nuk do të doja ta merrja përsëri fjalën, sepse duhet t'ua japim fjalën fëmijëve. Ata na kanë dëgjuar mjaftueshëm.

Kam një kërkesë. Do të doja t'i depozitonit në parlament, nëse do të ishte e mundur, të gjitha rekomandimet që keni pasur në konsideratë për ndryshimet e bëra në nenet përkatëse.

Unë jam i bindur se të gjithë ne, deputetët, do të jemi bashkë për të mbështetur nenet që i vlerësojmë si të domosdoshme, por, nga ana tjetër, duhet të kemi argumente, se çfarë thotë Konventa e Këshillit të Europës për këtë çështje...

Ju thatë se nuk kemi dalë mirë me raportimin.

Çfarë thotë raportimi?

A i ka lënë qeverisë shqiptare detyra për ndryshime në Kodin Penal, siç mund të ketë lënë EKRI për krimet kundër racizmit, GREVIO për dhunën në familje...? Do ta vlerësoja shumë nëse do të kishim edhe direktivën përmbledhëse, për të folur edhe me Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit në parlament, se sa është e detyruar Shqipëria t'i përmbushë këto detyrime, kohën që duhet e të tjerë.

Të nderuar kolegë, dua t'ju vë në dijeni se Ministria e Drejtësisë ka ngritur e grupin e punës për hartimin e Kodit të ri Penal. Duke bërë kaq shumë ndryshime dhe ndërhyrje, kjo mund të disbalancojë edhe më keq seç është i disbalancuar Kodi Penal.

Mos harroni, zoti Hazizaj, numri i ndryshimeve që sillni ju, është shumë më i madh se ndryshimet që kanë sjellë gjithë deputetët për 5 grupet e veprave penale, ku hyjnë: siguria ushqimore, armët, siguria rrugore, lëndët kimike, medikamentet, pyjet, Flora dhe Fauna. Pra, ju e keni kaluar të gjithë paketën, që kanë depozituar kolegët.

Faleminderit!

Altin Hazizaj – Faleminderit!

Po e nis nga pyetja e fundit, nëse do ta lemë Policinë e Shtetit të ndjekë këto lloj veprash penale që, në fakt, nuk janë vepra penale.

Në fakt, kërkesat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve kanë filluar nga viti 2015 e në vijim. Nëse do të shikojmë komunikimet që kemi pasur me Kuvendin e Shqipërisë, do të vëmë re se këto komunikime qëndrojnë vetëm për Kodin Penal, sepse për ligjet e tjera përgjithësisht kemi pasur eksperiencë pozitive. Unë, si jurist, duhet të pranoj faktin se Kodi Penal ka nevojë për ndryshime, në mënyrë që të përmirësohet dhe të dalë me një draft të ri. Ne, si zyrë, e mbështesim këtë gjë, por, nga ana tjetër, vihemi para një rreziku që ndodh çdo ditë. Ky rrezik mund të ndodhë edhe në këtë moment që flasim, sepse një fëmijë, një vajzë apo një djalë mund të jetë duke u dhunuar seksualisht *online*. A do ta lemë pa mbrojtje apo do ta mbrojmë? Kjo është një pyetje shumë e thjeshtë.

Këtu u bënë disa pyetje, por për sa i përket bulizmit mund të them se në të gjithë Europën pasoja që sjell bulizmi gjithmonë e më shumë po shihet si vepër penale. Shtete të tjera për trajtimin e bulizimit kanë kaluar nga masa sociale në masa më konservatore dhe më ndëshkuese, siç është dënimi me burgim. Pse? Sepse ka raste kur (ne kemi trajtuar tri raste në zyrë) një fëmijë mund t'i jetë bërë një video virale në internet apo në rrjetet sociale, ku, pavarësisht se nuk i duket fytyra, vetë fëmija e di që është ai aty dhe bën tentativë për vetëvrasje. Tentativa për vetëvrasje konsiderohet krim, por jo për atë që tenton të vrasë veten. Kjo do të thotë se ai person është shtyrë të kryejë një krim, e para...

Vasilika Hysi – Më falni, ndoshta ju e keni keqkuptuar pyetjen. Pyetja ishte: si mund të prodhohet denigrimi dhe a ka mundësi të rregullohet me ligje të tjera? Bulizmi shpesh ndodh midis fëmijëve. A do të thotë kjo se çdo gjimnazist do të shkojë në burg për denigrimin që i bën shokut apo shoqes? Këtu po flasim për moshën 14 -18 vjeç. A do të popullohen masivisht burgjet shqiptare me adoleshentë? Unë jam kundër dënimit të fëmijëve, sepse bulizmi shpesh ndodh midis fëmijëve, pra me njëri-tjetrin, kryesisht në shkollë. Unë këtë merak kam, sepse do të kemi më shumë fëmijë në burgje, djem e vajza, sesa të rritur. Prandaj, a ka mundësi që ta rregullojmë këtë gjë me një ligj jo penal dhe me fushatë të tjera në forcim të institucioneve? Të jeni i bindur, zoti Altin, dhe ju vetë do të shikoni, se do të kemi shumë fëmijë në burgje, sepse përgjegjësia fillon në moshën 14 vjeç. Pra, çdo fëmijë i moshës 14 deri në 18 vjeç do të jetë në burg për çdo ngacmim që do t'i bëjë shokut apo shoqes?!

Altin Hazizaj – Në qoftë se do të shikoni formulimin, do të vini re se ne kemi qenë tepër të kujdesshëm për sa i përket ndarjes ndërmjet asaj që konsiderohet bulizëm me pasojë të lehta dhe bulizmit me pasojë të rënda. Pasoja e rëndë është kur ka shkaktuar plagosjen ose vetëvrasjen e fëmijës dhe dënohet me burgim nga 3 deri në 5 vjet.

Shtytysa që i bëhet një fëmijë për të vrrarë veten në të gjithë Europën po konsiderohet vepër e rëndë penale dhe vepër e ndëshkueshme penale. Rekomandimi është që bulizmi me pasoja të rënda të trajtohet si vepër penale, Nëse do të pyesim fëmijët, të cilët e kanë paraqitur edhe në raportin e tyre, bulizmi është kthyer në problemin jetësor të tyre. Pa diskutim, që është një fenomen social dhe fenomenet sociale jo gjithmonë duan përgjigje penale, dhe jam shumë dakord për këtë gjë, por ajo që ne duhet të bëjmë është kombinimi i nismave sociale. Pra, të gjithë ne si shoqëri duhet të ndërgjegjësojmë fëmijët, adoleshentët dhe veten tonë për këtë çështje, para se të arrijmë te pasoja.

Ka shumë raste që fëmijët e kalojnë shumë lehtë bulizmin, e marrin me të qeshur dhe më pas e harrojnë, nesër përqafohen dhe janë shokë përsëri, por ka raste që fëmijët përfundojnë në vetëvrasje. Mendoni një familje që sot e ka fëmijën dhe nesër nuk e ka.

Për sa u përket pyetjeve të tjera, përpos bulizmit, mund të them se jemi munduar, që në vitin 2015, që një pjesë të veprave seksuale t'u bëjmë një rishikim të pjesshëm statistikor për sa u përket krimeve seksuale në Shqipëri. Këtu ndodhet edhe Mirsida, e cila sot punon për UNICEF-in, dhe të dy bashkë kemi bërë një rishikim statistikor, ku vetëm gjysma e krimeve seksuale dënohen nga gjykatat në Shqipëri, gjysma nuk dënohen. Kjo është një statistikë e përafërt me vendet e BE-së, që shkon diku te 60%, kurse Shqipëria e ka 50%. Ne jemi duke përgatitur një studim 10-vjeçar për të gjitha krimet seksuale, ku kemi marrë statistikën e plota. Këtu gjej rastin të falënderoj të gjitha institucionet që iu përgjigjën kërkesës sonë. Nga shikimi paraprak, na rezultoi se, në mënyrë të pashpjegueshme, sepse nuk është thjesht vërtetimi, kemi një diferencë ndërmjet raportimeve në polici, raportimeve në prokurori dhe raportimeve në gjykatë.

Vasilika Hysi – Kjo është normale dhe ndodh për të gjitha veprat.

Altin Hazizaj – Jo, nuk është normale, sepse ne do të preferonim më mirë që të jetë gjykata ajo që do të japë vendimin final për sa i përket fajësisë ose pafajësisë së një personi, që ka kryer një vepër penale seksuale, sesa të jetë policia apo prokuroria, të cilët mund ta quajnë “në kushtet e mosprovimit të veprës penale”. Pra, ne do të preferonim që raste të tilla, për shkak të natyrës së tyre, të përfundojnë të gjitha në gjykatë, edhe kur dyshimi vërtet mund të jetë i mosprovuar.

Vasilika Hysi – Besoj se do të na i sillni materialet?

Altin Hazizaj - Patjetër!

Vasilika Hysi - Të nderuar përfaqësues, a mund t'i dëgjojmë edhe fëmijët, më pas të vazhdojmë me pyetjet?

Po, zonja Tyli, Komisionere tek Avokati i Popullit.

Matilda Tyli – E nderuar kryetare,

Unë jam Komisionerja për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Së pari, dua të falënderoj zotin Hazizaj për ftesën dhe mundësinë për të qenë këtu të pranishëm, gjithashtu edhe për iniciativën për të paraqitur ndryshime në Kodin Penal, sidomos kur flasim për vepra penale, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me fëmijët!

Unë do të sugjeroja vetëm dy gjëra: së pari, nëse do të duam të ndërhyjmë në Kodin Penal këto ndërhyrje, duhet të jenë të studiuara, të harmonizuara dhe të lidhura me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, sidomos në rastin e përcaktimit të moshës së përgjegjësisë penale për të miturit.

Duke pasur parasysh rastin e Kavajës, ku të dyja palët, edhe viktimat e abuzuar, por edhe të pandehurit e dyshuar që kanë konsumuar veprën penale ishin të mitur, duhet të kemi shumë kujdes për sa i përket përcaktimit të moshës së përgjegjësisë penale, pasi çdo gjë duhet të reflektohet në harmoni me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Gjithashtu, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur në themel të tij ka shmangien nga masat e dënimit dhe programet e restaurimit dhe ndërmjetësimit në mënyrë që fëmijët e mitur në konflikt me ligjin, viktimat apo dëshmitarë të mos penalizohen dhe ndëshkohen. Pra, fryma e kodit është një qasje krejtësisht e re, sepse bëhet fjalë për riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre nëpërmjet programeve të ndërmjetësimit dhe restaurimit.

E dyta, e cila është në formën e sugjerimit, Shqipëria prej kohësh, e përfaqësuar nga institucioni i Avokatit të Popullit, është anëtare në Rrjetin Europian për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, pra network-u i ombudsmanëve të të drejtave të fëmijëve të ENOK-ut.

Këtë vit ENOK-u ka mbledhjen vjetore në lidhje me të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital. Përpara një jave përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në *spring meeting* të ENOK-ut për të diskutuar qasjen që duhet të kenë fëmijët në ushtrimin e këtyre të drejtave, pra nuk është ideja për t'u mohuar atyre navigimin në internet, por për krijimin e kushteve që ata të jenë të mbrojtur që të promovojnë benefitet, sepse zhvillimi i teknologjisë dhe informacionit ka krijuar mundësi që edhe të mësuarin ta marrin nëpërmjet internetit, duke shfrytëzuar *primary* dhe *secondary resources*, pra burimet parësore dhe sekondare, të kenë njohuri dhe të mbledhin informacion sa më shumë që të jetë e mundur e kështu me radhë.

E dyta, mënyra se si duhet t'i ushtrojnë këto të drejta. Kjo lidhet edhe me faktin se si qeveritë dhe institucionet e tjera shtetërore garantojnë dhe promovojnë këto të drejta. Kjo është e fokusuar kryesisht në standarde ligjore, akademike dhe politike në mjedisin digjital.

Në ENOK do të miratohet një draftrezolutë, e cila po qarkullon për mendime tek anëtarët e rrjetit, ku do të ketë rekomandime të posaçme për mënyrën sesi ushtrohen të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital dhe cilat duhet të jenë politikat që shtetet ndërmarrin në këtë kuadër për t'u garantuar një mjedis të sigurt. Unë sugjeroj që këtë rezolutë që do të miratohet nga ENOK-u, së bashku me rekomandimet përkatëse ta bëjmë pjesë të brendshme të punës sonë dhe të shikojmë se sa dhe si është e mundur t'i përkthejmë ato në politika dhe në legjislacion, kryesisht të lidhura me ndryshimet në Kodin Penal, por edhe më gjerë nëse do të jetë nevoja për të pasur një ligj të posaçëm për të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Altin, nuk ia dalim dot. Në orën 3:30 dua ta mbyll mbledhjen, sepse kam një mbledhje tjetër.

Altin Hazizaj – Kam një koment të shkurtër. Krimet seksuale janë të rënda, nuk janë krime të lehta. Pra, nuk mund të flasim për përmirësimet që vijnë nga institucioni penal kur krimet janë të lehta, sepse kjo ka të bëjë me shkeljen e dinjitetit, me shkeljen e trupit dhe me shkeljen e paprekshmërisë trupore. Në shumicën e rasteve këto krime dënohen 5 apo mbi 7 vjet. Kjo do të thotë se nuk jemi në kushtet e politikës penale, ku me të drejtë të miturit duhet të përfitojnë masa sociale, krahasuar me politikën ose me ndëshkimin penal, por përkundrazi jemi në një moment kur shteti i ofron mbrojtje individëve. Masat penale në Shqipëri janë më të ulëta krahasuar me ato të Bashkimit Europian dhe të Amerikës.

Në Amerikë të prekësh thjesht trupin, jo seksualisht, mund të shkosh deri në 3 vjet burg, sepse trupi yt është i paprekshëm. Në Shqipëri jemi mësuar që trupin të na e prekin të gjithë dhe nuk na bën përshtypje.

Pra, kemi nevojë që edhe me masa penale t'i edukojmë njerëzit, që trupi i njeriut është i paprekshëm. Kjo është ajo që duam të realizojmë në fund fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit!

Ju përgëzoj për këtë iniciativë!

Ne kemi biseduar edhe me Altinin për nevojën e ndryshimeve në Kodin Penal, por unë dua të ndalem në dy momente shkurtimisht, meqenëse fjala është për fëmijët.

E para, prokuroria, gjykata, policia dhe të gjithë ekspertët që punojnë me çështjen e të drejtave të mbrojtjes së fëmijës duhet të njihen me ndryshimet në mjedisin digjital, të cilat nuk ka qenë si koncept më përpara. Për shembull, më përpara në Kodin Penal ka qenë “në

çdo mjedis”, ndërsa tani duhet të shtohen fjalët “në mjedisin digjital” meqenëse globalizmi ka efektet e tij.

E dyta, mendoj se duhet ende kohë për t’u futur në detaje të të gjitha kodeve, neneve dhe ndryshimeve që ka parashikuar CRCA-ja, sepse duhet parë me detaje zhvillimi i fëmijës, cila është përgjegjësia penale e të tjera. Pra, duhet të jemi të kujdesshëm, sepse fëmijët nuk e dinë se çfarë përbën një veprë penale dhe i bie që çdo fëmijë dhe çdo adoleshent të shkojë në burg.

Megjithatë është koha për ndryshimin e Kodit Penal, por për të parë me detaje përmasat e ndëshkimit, konotacionet, stigmatizimin dhe për masat ndëshkuese duhet të kemi shumë kujdes, sepse duhen parë grupmoshat që i përkasin. Pra, besoj se jemi dakord të gjithë për të bërë një ndryshim në Kodin Penal, por duhet të jemi të kujdesshëm për të gjithë fëmijët.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Të gjithë të ftuarit e institucioneve dhe shoqërisë civile do të kenë mundësi për ta studiuar draftin, sepse projektin e propozimeve e kemi vendosur në dosjen tuaj. Do ta vlerësonim shumë nëse do të kishim komente dhe sugjerime përpara se nisma e deputetëve të diskutohet, sepse, nëse do të dakordësohen, atëherë do të depozitohen si propozime gjatë diskutimit në Komisionin e Ligjeve.

Meraku im është se me ndryshimin e këtyre neneve ne do të dënojmë më shumë fëmijë sesa të rritur. Nëse bëjmë një studim, këtu do të kërkoja edhe ndihmën e UNICEF-it, se kush e shkakton më shumë bulizmin të rriturit apo të miturit, djemtë apo vajzat, ne do të shikojmë se gjysma e gjimnazeve duhet të shkojnë në burgun e Kavajës ose me Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur në shërbim prove, në shmangie. Pra, pa dalë ende në jetë këtyre personave ne i vendosim vulën si të dënuar dhe ia shkatërrojmë jetën përjetësisht.

Altin, unë nuk do të doja ta diskutonim, sepse jam kundër ndryshimit të Kodit Penal te fëmijët. Ju e dini shumë mirë që kam luftuar të mos ketë burgime për fëmijët, por në rastin konkret, për hir të luftës që doni ju, unë e kuptoj shqetësimin tuaj për veprat penale, kam frikë se pjesa më e madhe e autorëve do të jenë fëmijë.

Faleminderit!

Prezantimi i Raportit për të drejtat e fëmijëve

Vasilika Hysi – Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, në prezantimin e raportit për të drejtat e fëmijëve.

Të ftuar kemi fëmijët: Alida Zeqiraj, Amadea Jakupi, Arnold Ismailanji, Akela Pici, folëse, sekretare e Parlamentit Rinor në Tiranë, Erti Poka, Enea Dermynshi, Kejsi Shehu, folëse, kryetare e Parlamentit Rinor në Tiranë, Vanesa Mulaj, Marsela Delija, folëse, nënkryetare e Parlamentit Rinor në Tiranë, Marsida Bajrami, Olta Shqau, Rigers Dervishi dhe Klaudio Prifti.

Për transparencë dhe në respekt të pjesëmarrësve, të ftuar nga shoqëria civile kemi: Klaudio Pulaha, Mirgit Vataj, përfaqësues i “ ALO 116-111 Shqipëri”, Linda Pino nga Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, Anila Meço. Nuk e di, nëse ka ardhur Anila?

Përshëndetje “Save the children”! Altin Hazizaj, të cilin e dëgjuam në pjesën e parë, Rovena Vuksani, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Matilda Tyli, nënkomisionere e Avokatit të Popullit, Julian Papaproko, “World Vision Shqipëri”, a ka ardhur Juliani? Po, faleminderit! Kleopatra Gjina, Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Mersila Ballo nga UNICEF-i.

Janë të pranishëm edhe komisionerja për të drejtat e fëmijëve Nela Peka Osmani nga Avokati i Popullit, si edhe drejtoresha e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve Alma Tandili. Meqenëse ne bëmë një takim edhe më parë lidhur me të drejtat e fëmijëve, Alma është e pranishme. A ka ndonjë nga të ftuarit që nuk e ka dëgjuar emrin?

Të rinjtë, fëmijët kanë të drejtën të prezantojnë raportin. Do t’ju lutesha shkurt, sepse ne kemi përpara një kopje të raportit dhe kemi më tepër dëshirë të bëjmë pyetje dhe të diskutojmë me njëri-tjetrin.

Kejsi Shehu - Përshëndetje!

Jam kryetare e Parlamentit Rinor të Tiranës.

Në fillim dua t’ju falënderoj shumë për mundësinë!

Jam shumë e lumtur që ndodhem këtu sot mes jush.

Parlamenti rinor ka si qëllim fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e vendimmarrjes së tyre në shoqëri.

Do të doja t’ju ftoja të bashkoheshit me ne, me qëllimin tonë që të kemi edhe aktivitete të tjera të ndryshme, si ky i sotmi, sepse një ditë ne aspirojmë të jemi në vendin tuaj.

Shkurtimisht po prezantoj raportin, i cili është krijuar nga vetë ne si organizatë, Parlamenti Rinor, Tiranë me ndihmën e “ Zërit 16+” në Burrel, në Peshkopi, në Durrës dhe në Elbasan.

Vetë raporti është “Fëmijë avokojnë për fëmijët”. Qëllimi i kërimit është të evidentojë problemet kryesore që shqetësojnë fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri, që ata i konsiderojnë si shkelje të të drejtave të tyre; të caktojë prioritetet e fëmijëve dhe të rinjve si në nivel kombëtar ashtu dhe në qytet sipas këndvështrimit të tyre, duke rekomanduar njëkohësisht, edhe zgjidhjet, edhe veprimet; të përgatisë fëmijët dhe të rinjtë që të drejtojnë procesin e kërimit me pjesëmarrje, duke kontribuar me mendimet e tyre, duke evidentuar problemet dhe duke rekomanduar zgjidhje.

Objektivat që ky kërkim ka si qëllim janë: të aftësojë fëmijët dhe të rinjtë për të evidentuar dhe analizuar çështjet më shqetësuese për shkeljen e të drejtave të tyre; të fuqizojë kompetencat e fëmijëve dhe të rinjve mbi të drejtat e fëmijëve; të pajisë fëmijët dhe të rinjtë, por edhe institucionet partnere me metodologjinë e kërimit për pjesëmarrje si një mjet të rritjes së pjesëmarrjes dhe të angazhimit të fëmijëve nga njëra anë, po ashtu edhe të identifikimit të problemeve dhe adresimin e tyre së bashku me fëmijët; të ndërgjegjësojë institucionet publike në nivel kombëtar përmes rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të adoleshentëve, të garantojë që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret në konsideratë përgjatë hartimit të politikave vendore dhe kombëtare, si dhe të adresohen mangësitë e evidentuara nga fëmijët nëpërmjet planeve të avokimit për të drejtat e fëmijëve dhe dialogut me institucionet qendrore dhe vendore.

Metodologjia, që është përdorur në bazë të këtij raporti, është hartimi i pyetjeve bazë të studimit, organizimi i fokusgrupeve me fëmijët. (Ne kemi bërë edhe një trajnim dyditor për avokimin e të drejtave të fëmijëve, ku kanë marrë pjesë një grup pjesëmarrësish nga parlamenti rinor dhe “ Zëri 16+” në Burrel, në Peshkopi, në Durrës dhe në Elbasan. Kanë qenë dy ditë të mbushura me diskutime intensive); hartimi i pyetësorit bazë në konsultim me fëmijët, përpunimi i të dhënave, identifikimi i gjetjeve, i vështirësive e të tjera, hartimi i draftit të parë të raportit, ndarja e gjetjeve të raportit me fëmijët, me të rinjtë dhe partnerët e organizatave të tjera, si dhe finalizimi i raportit dhe prezantimi i tij në ditën e fëmijëve në qershor.

Marsela Delia- Përshëndetje!

Jam nënkryetare e Parlamentit Rinor, Tiranë.

Doja të vazhdoja me numrin e fëmijëve dhe të rinjve të trajnuar gjatë kërkimit në pjesëmarrje. Kemi gjithsej 337 të rinj, ku 106 janë djem dhe 231 janë vajza. Përkatësisht në qytete të ndryshme: në Tiranës, në Durrës, në Elbasan, në Burrel dhe në Peshkopi.

Për të vazhduar me numrin e fëmijëve dhe të rinjve që u përfshinë në kërkim me pjesëmarrje për të plotësuar pyetësorët. Për qytete të ndryshme janë përkatësisht: në Tiranë 196, në Durrës 46, në Elbasan 48, në Burrel 152, në Peshkopi 65 dhe gjithsej janë 507.

Gjetjet kryesore

Respektimi i të drejtave të fëmijëve në përqindje: janë përgjigjur me “po” vetëm 14%, me “jo” 11 %, 74% janë përgjigjur me “disi” dhe “nuk e di” me 1%.

Në shumicën e rasteve të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve nuk respektohen ose respektohen disi si në institucionet publike, në shkolla, bashki e të tjerë, ashtu edhe në familje apo në komunitetin ku ata jetojnë.

Problemet kryesore me të cilat përballen fëmijët në Shqipëri dhe që ndikojnë në gjendjen e të drejtave të tyre, në përqindje: martesat e hershme me 1%, siguria në internetin e fëmijëve me 2%, puna e pamjaftueshme e institucioneve me 1%, trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve me 3%, mungesa e sigurisë me 2%, mungesa e perspektivës me 16%, me 2%, korrupsioni, puna e fëmijëve, mungesa e shërbimeve, mungesa e ndihmës nga shteti me 3%, mungesa e pjesëmarrjes me 4%, mosnjohja e të drejtave të fëmijëve me 2%, papunësia e prindërve me 7%, gjendja jo e mirë e shkollave me 1%. Për të vazhduar me gjendjen shëndetësore, dhunën në komunitet dhe dhunën, bulizmin në shkollë me 23%, dhuna në familje 3%, cilësia e ulët e arsimit 17% dhe varfëria 18%.

Dhuna dhe bulizmi në shkollë mbetet një nga problemet më shqetësuese dhe një nga shkeljet më flagrante të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Akela Pici - Përshëndetje!

Jam sekretare e Parlamentit Rinor, Tiranë.

Tri problematikat më shqetësuese që janë adresuar nga fëmijët dhe të rinjtë në mbarë vendin në këtë raport janë:

- 1.Dhuna dhe bulizmi në shkollë
- 2.Varfëria
- 3.Mungesa e perspektivës

Përgjegjësit për realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar janë paraqitur me statistika në përqindje: komuniteti ndërkombëtar 26%, Policia e Shtetit 27%, OJQ-të 13%, Avokati i Popullit 21%, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të

Fëmijëve 49%. Përqindjen më të lartë e ka zënë familja me 56%, shkolla 47%, bashkia 30%, qeveria 46% dhe Kuvendi 33%.

Varfëria ka një ndikim negativ për sa i përket ushtrimit të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Ky është një nga rezultatet e këtij raporti.

Vlerësimi për punën e qeverisë për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri është paraqitur me statistika, ku 11% janë përgjigjur me “po”, 30% me “jo”, “disi” 56 dhe 3% e ka zënë përgjigjja “nuk e di” ...

Gjithashtu, ky raport ka nxjerrë disa rekomandime.

Së pari, të krijohet një mekanizëm kombëtar për raportimin, reduktimin dhe parandalimin e bulizmit në shkollat nëntëvjeçare e të mesme në mbarë vendin, si dhe të shtohet numri i punonjësve të shërbimit psikosocial nëpër shkolla.

Të rritet buxheti i shtetit për fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë që të mbështeten më shumë në aktivitetet e tyre edukuese, informuese, fuqizuese në mbarë vendin, si dhe që zëri i tyre të dëgjohej në institucionet shtetërore e arsimore.

Një zë rekomandim është edhe që qeveria të marrë masa për uljen e varfërisë, të hartojë programe për nxitjen e punësimit, si dhe të ofrojë mbështetje sociale për të gjitha familjet në nevojë.

Së fundi, është që të rriten investimet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të përmirësuar infrastrukturën e arsimit në të gjitha shkollat në Shqipëri, në mënyrë që të rritet edhe cilësia e arsimit.

Ju falënderoj!

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit Akela, Kejsi dhe Marsela!

Fjala është e hapur për pjesëmarrësit, për pyetje. kanë të drejtë të pyesin deputetët, të ftuarit, fëmijët e tjerë. Pastaj, se kush do të përgjigjet, kjo është zgjedhja e folësve.

Keni pyetje?

Enver Roshi – Mund të bëj një pyetje?

Vasilika Hysi – Po.

Enver Roshi – Si e keni matur ju dhunën në familje, se më rezultoi 3 %? Ndërkohë, të dhënat tona tregojnë se dhuna në familje është shumë herë më e lartë. Duket se ekspozimi në familje reflekton edhe edukimin në shkolla apo bulizmin.

Altin Hazizaj – Po të përgjigjem unë, sepse është diskutim me të dhëna. E para, të dhënat e prezantuar janë vetëm në nivel kombëtar, sepse ka të dhëna edhe në nivel vendor. Ajo që është më e rëndësishme, është se ka të bëjë pak edhe me procesin. Pra, për ne të rriturit dhuna në familje mund të jetë një qëndrim ose një fenomen, me pasojën e të cilin ne

përballemi më shpesh ose e ndjejmë më shumë. Ndërkohë, pa diskutim, e dhe kur ekziston dhuna në familje, tendenca e prindërve është që në shumicën e rasteve t'i mbrojnë fëmijët nga shfaqja e dhunës në familje. Ajo që vlen për t'u theksuar, është se për fëmijët, tendenca është që t'i shikojmë problemet që ndikojnë direkt tek të drejtat e tyre, krahasuar me fenomene që mbase vijnë nga të tretët, qoftë dhe prindërit e tyre, por që jo detyrimisht edhe fëmija i interpreton si një problem ose një shkelje të të drejtave të tyre. Domethënë, kjo është diçka që duhet shikuar.

Në esencë, për t'iu kthyer pak edhe procesit, kam punuar mbi një vit e gjysmë për të evidentuar ato që janë problemet dhe faktorët më ndikues në të drejtat e tyre. Pritshmëria jonë, si të rritur, ka qenë ndryshe. Po të shikojmë një ndër skemat ose grafikët që u prezantuan, familja del e para në mbrojtje të fëmijëve. Ne kishim menduar dhe bindja jonë ka qenë se do të ishte shteti. Pastaj, këtu përfshihen të gjitha institucionet. Për shkak se fëmijët janë shumë të ekspozuar edhe me shoqërinë civile, kishim menduar se shoqëria civile do të ishte shumë më tepër se 13 %. Ky është perceptimi i fëmijëve, ky është qëndrimi i fëmijëve, që tregon diferencë të theksuar – duhet ta them këtë – midis çfarë konsiderojmë ne shkelje të të drejtave të fëmijëve, dhe çfarë konsiderojnë fëmijët shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Në qoftë se flasim ne të rriturit, ne mendojmë dhe gjykojmë se shumica e fëmijëve gëzojnë të drejta të plota. Ky është qëndrimi ynë, dhe përgjithësisht i organizatave me eksperiencë. Po të shikosh fëmijët, shumica e tyre thonë; jo, nuk respektohen, vetëm disi.

Pra, ne në vetvete, kemi një botëkuptim, i cili nuk i përgjigjet realitetit që vetë fëmijët, vetë adoleshentët jetojnë.

Vasilika Hysi – Në fakt, Altin, është e vërtetë që jemi breza të ndryshëm dhe mendojmë ndryshe. Ne themi se fëmija ka të drejtë të dalë, por në orë të caktuara, ndërsa ai thotë: kam të drejtat e mia, dhe do të dal kur të dua unë!

Megjithatë, mua mu duk shumë interesante tek përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve. Besoj se ishte gjetje shumë interesante, që familja është shtylla. Familja është e para.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse fëmijët janë më të sigurtë. Është familja, është shkolla, pastaj institucionet, dhe kur ato nuk mundin dot, fillon shteti, i cili nëpërmjet shërbimeve sociale mbush defektet e familjes. Në qoftë se ne humbasim qelizën, bërthamën e shoqërisë, sado të punojë sado shteti, shteti ndërhy, është komplementar kur familja ka dështuar.

Megjithatë, këtu kemi përfaqësues të institucioneve të ndryshme, dhe ne do ta studiojmë me vëmendje raportin, sepse të gjithë e kemi përpara.

Unë do të doja t'ju falënderoja të gjithë ju të rinjve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, më fal, Almira! Deputetja Xhambulla, kishit për të folur? Më falni! Ndjesë, se s'e vura re!

Almira Xhambulla – Faleminderit, kryetare!

Almira Xhambulla, deputete e qarkut të Dibrës.

Ju falënderoj shumë për studimin që keni bërë! Vajzat i falënderoj për prezantimin! Do të doja ta shihja pak në planin lokal, duke qenë se bashkë me Altinin, por edhe me përfaqësuesin e linjës këshillimore, ne kemi pasur raste të diskutojmë pak sa i takon qarkut të Dibrës dhe specifikave që ka. Sigurisht, nuk jam e kënaqur me gjetjet, sepse nuk do të doja të ishim në këto nivele, por jam e kënaqur që ka qenë një ndër zonat e përfshira në studim.

Dua të sqaroj pak edhe rekomandimin që ka të bëjë me ngritjen e qendrës rinore. Unë vetë e kam ngritur si shqetësim. Ka qenë thjesht një mosdakordësi e këshillit bashkiak. Më vjen mirë që ka dalë edhe këtu te rekomandimet tuaja. Patjetër që do ta ndjekim dhe do të jemi partnerë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Thjesht ka qenë një nismë shumë e mirë. Qendra rinore duhej të ngrihej, por thjesht ka qenë një koordinim jo i mirë me këshillin bashkiak të Peshkopisë.

Për sa i përket të gjithë asaj që u tha në nivel kombëtar, besoj se lidhur edhe me politikatat e ndërmarra, jam e bindur se niveli kaq i lartë vjen pak edhe nga mosnjohja apo mosdhënia e informacionit tek të rinjtë, me politikatat që ndërmerren. Sigurisht që ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi akoma shumë hapa për të bërë, por jam e bindur se ne akoma nuk po bëjmë aq s duhet për sa i përket dhënies së informacionit për politikatat apo kuadrin ligjor që ne ndërmarrim.

Besoj se të gjithë ne ndjehemi mirë se disa nga nismat, si për shembull ligji “Për nxitjen e punësimit”, që ne kaluam tash së fundi në parlament, apo disa paketa të tjera ligjore, të cilat reflektonin konkretisht disa nga gjetjet e studimit. Kësisoj, ju falënderoj, dhe do të jemi patjetër partnerë në adresimin e këtyre çështjeve. Mund të bashkëpunojmë sa here që të jetë e mundur.

Faleminderit!

Suksese!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhambulla!

Unë kam një pyetje për të tria folëset: Si formohen të rinjtë për nismat ligjore, programet mbështetëse që miraton qeveria, ministrinë apo bashkitë?

Vura re se bashkitë që mbajnë përgjegjësinë kryesore të ofrimit të shërbimeve nuk targetoheshin nga të rinjtë, çka tregon që informimi ligjor për përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve lë shumë për të dëshiruar tek të rinjtë, sepse më shumë i kishin dhënë kompetencë Kuvendit dhe qeverisë, ndërkohë që ne merremi me ligjet, por shërbimet, mbështetjen dhe gjithçka për fëmijët i ka bashkia.

Cilat janë mekanizmat që përdorni për të marrë informacion për shërbimet?

Akela Pici – Personalisht, për shkak të punës që kemi bërë me parlamentin rinor dhe me organizata të ndryshme unë jam informuar për të gjitha organizatat që ne kemi në raport apo për të gjitha institucionet.

Në qoftë se flas në përgjithsi, në shkollën time apo në përgjithësi për të rinjtë e Shqipërisë doja të thosha se është e vërtetë që mungon informacioni. Mendoj se duhet të bëhet një punë më e mirë nëpër shkolla, duhet të informohen më tepër të rinjtë, duhet të informohen organizata rinore për punët që ka bashkia, që ka Kuvendi apo qeveria në mënyrë që ne vetë të bëjmë dallimin.

Për shembull, nëse pyesim një të ri në një gjimnaz të Tiranës se çfarë është ASHMDF-ja (Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve), ndoshta nuk do ta dijë, por mund të bëjë thjesht lidhjen me akronimin. Pra, mendoj se ka një mungesë informacioni dhe duhet të bëhet një punë më e mirë nga shkollat.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Kam ndjekur me vëmendje një studim lidhur me besimin që kanë të rinjtë te politika. Unë si deputete, por besoj se çdo deputet tjetër, takohem me të rinjtë, të cilët bëjnë ca pyetje, me idenë që të zgjidhin ca probleme që nuk janë në kompetencën e deputetit, çka tregon se të rinjtë nuk e dinë se partitë nuk e ofrojnë atë gjë, deputeti nuk e ofron atë gjë dhe konstatoj se ka një mungesë të madhe informacioni dhe normalisht nuk kanë besim te partitë. Në qoftë se ai mua më kërkon diçka që deputeti nuk e ka pjesë të përgjegjësisë së vet, ai nuk mund të të mbështesë.

Mua më bëri përshtypje studimi që shumë të rinj nuk besojnë te partitë dhe kur i pyet se cilat janë funksionet e partive apo përgjegjësitë e deputeteve ngelin dhe pastaj i bien shkurt, mungesë besimi. Unë kam pak dyshim te metodologjia, por do ta lëmë një pikë më vete.

A i keni përdorur përgjigjet online? Pse e them këtë? Çfarë ka rezultuar?

Ju e dini se unë kam bërë shumë studime, me vite e vite, dhe kam konstatuar (kur me Gallupin bënim studime, *face to face*, anketë), të dhënat na dilnin më të sakta, ndërsa kur i bënim me internet uleshin 5-6 të rinj dhe ia fushnin një të plotësuar.

E para, nuk përzihet dot sipas marzheve dhe përbërjes.

E dyta, mund të manipulohen shumë më lehtë, sepse, në qoftë se unë dua që për një problem të caktuar ta nxis situatën, unë marr gjithë mbështetësit e një force politike dhe i them që të plotësojnë online sipas dëshirës time. Ju e dini shumë mirë, se kur ne deputetët na fusin në një anketë gazetave, asnjë nga ne që jemi këtu nuk morëm pikë, ama nuk kryesuat listat, por me gjithë modestinë ishim deputetë shumë më të mirë se ata që merrnin 70-80% të mbështetjes. Kjo tregon se mundësia për të manipuluar anketimin online është shumë e madhe. Po të ishte për anketat e gazetave të mëdha, unë nuk do të isha në parlament, se një herë kam marrë 1% e një herë 3%, kurse një person me rekorde kriminale kishte marrë 68%.

Altin Azizaj – Dua të bëj një sqarim për metodologjinë, meqenëse kemi qenë së bashku me Save the Children, që kemi lehtësuar procesin. Fëmijët janë pjesë ose e parlamentit rinor të Tiranës, ose e katër grupeve të zërit 16+.

E dyta është një kërkim me pjesëmarrje, që do të thotë se i gjithë procesi kontrollohet nga vetë fëmijët. Pra, nuk është si për ne të rriturit që mund të mblidhemi të gjithë së bashku (ndjesë për këtë që po them) dhe t'i futemi Likës ta denigrojmë në aspektin politik. Pra, fëmijët kanë qenë në një mjedis të caktuar, kanë qenë të gjithë së bashku dhe para se të dilnin problemet, kanë kaluar një vit të tërë të përgatitjes së tyre për të marrë pjesë në proces, të kuptojnë se ç'është procesi, të arrijnë të evidentojnë problemet vetë dhe shumë më vonë, në fund të vitit është dërguar pyetësori online, më shumë për të validuar të gjitha gjetjet që vetë fëmijët i kanë pasur përgjatë një viti.

Të gjithë ata që e kanë propozuar janë shkencëtarë socialë dhe nuk bëhet rastësisht me pyetësorë dhe pa e dituar kush do ta plotësojë.

Vetë fëmijët janë të gjithë të evidentueshëm nëpërmjet adresës së tyre të eimeilit, domethënë ka pasur disa masa kontrolli për të eliminuar plotësimin e pyetësorëve nga të tjerët.

E treta, janë vetë fëmijët që kanë komunikuar me fëmijët e tjerë. Pra, nuk jemi ne të rriturit. Ne kemi qenë jashtë procesit (po flas për validimin e të dhënave).

(Diskutime pa mikrofon)

Erti Poka – Jam anëtar i parlamentit rinor të Tiranës, njëkohësisht edhe president i gjimnazit “Qemal Stafa”.

Do të doja t'i ktheja përgjigje pyetjes suaj mbi mungesën e informimit që kanë të rinjtë.

Problemi i parë që unë vetë personalisht kam hasur në momentin kur kam dashur të marr informacion mbi një temë të caktuar në lidhje me institucionet kanë qenë sajtet

qeveritare. Sa herë ne futemi në një sajt qeveritar, që ka një “.gov” në fund, shohim se gjuha e përdorur nuk i afrohet aspak gjuhës me të cilën të rinjtë janë mësuar të kuptojnë termat politikë.

Pra, duhet të kuptojmë se të rinjtë në momentin e parë që duhet të kuptojnë një term të caktuar ligjor, duhet t’u shpjegohet në gjuhën, të cilën ata e kuptojnë.

Një problem tjetër që doja të ngrija është humbja e sensit të lëndëve shoqërore në shkolla. Unë jam në një gjimnaz të përgjithshëm, jam në drejtimin shoqëror dhe shoh që nuk ka nxënës që të mos i dijë ligjet e Njutonit, ndërkohë që 80% e tyre nuk dinë një kod të caktuar civil, i cili është në përditshmërinë e tyre. Sot ne duam të prodhojmë kryesisht shkencëtarë, ndërkohë që nuk kemi ende qytetarë të denjë që të dinë se çfarë të drejtash dhe përgjegjësisish kanë.

Pika tretë, është mungesa e kurrikulave mbështetëse. Kemi kurrikula për shëndetin riprodhues seksual, për edukim karriere dhe të tjera, ndërkohë që nuk ka kurrikula që të shpjegojnë legjislacionin. Pra, nëpër gjimnazet tona ne kryesisht bëjmë kurrikula të mirëfillta, të cilat nuk e shpjegojnë legjislacionin. Unë vetë jam gjimnazist, nuk e di nëse të tjerët kanë eksperiencë të tjera, por minimalisht në gjimnazin “Qemal Stafa”, ku unë jam, nuk na është ofruar mundësia për t’i pasur këto.

Pika e katërt, të cilën sapo e nxora tani me shpejtësi, është fakti pse ne i kërkojmë gjithmonë gjërat nga qeveria. Të rinjtë janë mësuar t’i marrin gjërat me praktikitet dhe në momentin e parë që ndodh diçka e keqe, i adresohen direkt politikës. Realisht ne nuk e dimë se çfarë pozite dhe detyrash ka bashkia, por thjesht dimë që bashkia ka të bëjë me pjesën e infrastrukturës, kaq është mendimi ynë për bashkinë, ndërkohë që për çdo gabim që ndodh ne i adresohemi direkt qeverisë, sepse këtë gjë kemi parë edhe nga eksperiencat e tjera të mëparshme.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, Erti, për 4 gjetjet që parashtrove!

Unë e prisja këtë gjë, pasi kam qenë vetë një nga autorët e teksteve të edukimit ligjor dhe më ka ardhur shumë keq kur e kanë hequr librin. Autorë të këtij libri kanë qenë katër profesoresha unë, Arta Mandro, Aurela Anasasi dhe Mariana Semini dhe kemi pasur lëndën e edukimit ligjor, ndërkohë që Klaudia po më thotë që është hequr dhe bëhen disa lëndë të tjera. Me anë të këtij libri ne informonim për të gjitha rregullat që kishin të bënin me marrëdhëniet, pronësitë e fëmijëve, detyrimet, Kodin Penal, Kodin Civil, të drejtat, si mund të shkosh në gjykatë edhe pse je fëmijë e shumë gjëra të tjera.

Kam një pyetje për Ertin dhe për të rinjtë e tjerë. Ne kemi miratuar strategjinë e edukimit ligjor të publikut ku një fokus të veçantë zë edukimi ligjor i fëmijëve. Tani ju jeni më të pjekur se shumë të tjerë, gjë që e treguat në komunikimin tuaj, por mosha thotë që ende jeni ende fëmijë.

A jeni në dijeni të kësaj strategjie dhe a dëshironi ju që ne t'ju angazhojmë për t'u përfshirë në zbatimin e kësaj strategjie, meqenëse zbatimin e saj do ta monitorojë Kuvendi i Shqipërisë, ndërsa në aspektin teknik do të jetë Ministria e Drejtësisë, e cila do të punojë në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me institucionet e tjera, ku një faqe të veçantë ia kemi lënë rishikimit të të gjitha faqeve zyrtare dhe linkut të posaçëm me gjuhën miqësore për fëmijët, për gjuhën e shenjave për ata që nuk kanë mundësi dhe për fëmijët që nuk shkojnë fare në shkollë.

Ju të gjithë keni celularë, por besoj se merrni shumë pak informacion në *Facebook*, faqe në të cilën të gjithë ministrat me një gjuhë shumë të thjeshtë hedhin të dhëna, si për shembull: u miratua kjo paketë apo ky program, ndërsa unë do të hedh sot pikërisht këtë që po diskutojmë këtu, si dhe disa pamje tuajat, në qoftë se do të na jepni leje, me qëllim që të njoftohen dhe të sensibilizohen edhe të rinjtë e tjerë që në parlament mund të shkohet dhe mund të dëgjohet, por edhe të kërkoni, sepse ju keni mundësi të jeni të pranishëm edhe në komisione të tjera ashtu siç erdhët edhe sot. Si e mendoni veten tuaj?

Erti Poka – Mendimi që më erdhi për momentin është praktika që ne e njohim si TFT (Trainers for Trainers). Po t'i shohësh senatet e shkollave, ato kryesisht janë grupime studentësh, të cilët mbahen si ajka e gjimnazeve dhe në fund të ditës gjëja e vetme që bëjnë është se thjesht mblidhen, bëjnë pak muhabet dhe ikin në shtëpi. Ajo që ne duhet të bëjmë është që t'i bëjmë ata faktorë dhe gjithkush prej tyre ta përcjellë informacionin nëpër klasat ku janë pjesë. Sado që ne të mundohemi dhe t'i themi ndonjë mësuesi që këtë informacion ta përcjellë nëpër klasa puna e tij është thjesht edukimi dhe nuk duhet të merret fare me këtë pjesë, të jemi realistë.

Çfarë propozimi do të kisha unë për të gjithë individët që janë të angazhuar? Propozimi që unë kam është që ata të kthehen në trajnerë për klasat e tyre, gjë që do të thotë se këta individë, pra një senat i caktuar me 30 nxënës, aq sa ka senati i shkollës sonë, të kishin mundësinë për të marrë një trajnim të caktuar nga profesorë, të cilët mund t'ua shpjegojnë në terma të thjeshtë dhe miqësorë për fëmijët dhe pikërisht këta fundit informacionin që do të marrin ta transmetojnë nëpër klasa.

Ju i bëtë parapritë redaktimit të faqeve qeveritare, pasi kjo ishte pika e dytë që doja të rendisja. Unë mendoj se është shumë e rëndësishme që të rinjtë të kenë mundësi ta marrin

informacionin bruto dhe jo aq të përpunuar sa ç'është aty në terma ligjorë e të tjera, pasi pa dyshim nuk është edhe aq i kuptueshëm për të gjithë.

Pika e parë, që është TFT-ja, dhe mundësia për të trajnuar persona, të cilët në të ardhmen do të jenë vetë trajner është shumë e rëndësishme, sepse kjo është mënyra më e drejtpërdrejtë për ta përcjellë informacionin.

Pra, nxënësi vetë e ka kuptuar idenë se për çfarë bëhet fjalë dhe këtë gjë më pas ua transmeton edhe të tjerëve. Në momentin e parë që një individ është i gatshëm të japë një informacion kjo do të thotë se ai vetë e ka kuptuar mjaft mirë. Mjafton që një elitë e caktuar të ketë mundësinë e marrjes së informacionit bazë dhe më pas kjo elitë e përcjell informacionin tek të tjerët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Po.

Kejsi Shehu – Unë jam Kejsi Shehu. Jam shumë dakord me të gjitha ato që tha Erti. Vetë parlamenti rinor përfshin 19 gjimnaze dhe nëse marrim edhe pjesëtarët e parlamentit rinor, të përfshijmë edhe zërin 16+, sikur këta pjesëtarë të trajnohen në bazë të kësaj atëherë ata vetë do të jenë shumë të apasionuar pas kësaj gjëje dhe këtë mund ta transmetojnë edhe te shoqëria e tyre. Mendoj se një ndër mënyrat më të mira që të rinjtë kanë është pikërisht transmetimi i informacionit.

Unë nesër, kur të shkoj në shkollë, mund t'ju them edhe të tjerëve që ekziston kjo gjë, sepse deri pak më parë nuk kam qenë në dijeni që një vendim i tillë ishte marrë. Pra, vetë të rinjtë për të rinjtë, mendoj se është pikërisht kjo ku ne duhet të bazohemi.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, Kejsi!

Klaudia është këshilltare ligjore në parlament, e cila asiston deputetët në çështjet e drejtësisë së të miturve, ka një sugjerim për ju.

Klaudia Hasanllari – Përshëndetje!

Pasi dëgjova me vëmendje propozimet e fëmijëve, unë mendoj se avantazhi më i madh që keni ju, duke u nisur edhe nga mosha juaj, është pikërisht komunikimi me njëritjetrin, pasi keni të gjithë kohën, dëshirën dhe vullnetin e mirë për t'i ndarë informacionet.

Unë mendoj të bëjmë një lidhje vullnetare edhe me stafin e Kuvendit, sidomos për pjesën teknike të këshilltarëve ligjorë, dhe në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Ministrisë së Arsimit apo të Drejtorisë Rajonale të organizojmë një apo dy takime në muaj me gjimnazistë nga gjimnaze të ndryshme, të cilët janë të interesuar, për t'ju shpjeguar anën teknike dhe ligjore në mënyrë që ju të merrni një edukim ligjor për çështje që janë me rëndësi të madhe për ju. Ky mund të jetë një lloj komunikimi i përbashkët ku ju të transmetoni

problemet tuaja të vazhdueshme, ndërsa ne do të përpiqemi t'ju asistojmë nga ana teknike në mënyrën e duhur dhe ju më pas këtë informacion ta përcillni mes njëri-tjetrit dhe të arrini rezultatet e kërkuara. Ndoshta mund t'ju vijmë në ndihmë sadopak.

Vasilika Hysi – Po, Altin.

Altin Hazizaj – Parlamenti rinor sapo ka finalizuar strukturën dhe është i bazuar i gjithë mbi modelin e parlamentit shqiptar, që do të thotë se në parim, meqenëse fëmijët tashmë i kanë caktuar nëpër komisionet përkatëse dhe dihet cili gjimnazist shkon në filan komision, cili është kryetari dhe sekretari, pra i kanë bërë zgjedhjet, ideja është që do të vijnë vet adoleshentët dhe të rinjtë dhe do të ndjekin edhe seancat dëgjimore, sot është e para dhe ata që kanë pasur mundësi të vijnë, kanë ardhur pasi një pjesë e mirë e tyre janë në shkollë dhe kanë provimet e maturës, që të mësojnë se si organizohet një seancë dëgjimore, si diskutohen ligjet.

Problemi që ne kemi pasur dhe kemi gjatë gjithë kohës është që projektligjet nuk prodhohen në gjuhën e fëmijëve, hiq rastin kur ne vetë si zyrë kemi prodhuar ligjin e fëmijëve dhe kemi bërë një draft për ta, por shumica e ligjeve të tjera nuk prodhohen për fëmijët, por ata mund të mësojnë këtu dhe automatikisht të shkojnë në gjimnazet e tyre dhe të mësojnë edhe të tjerët.

Kështu që është një ftesë edhe për parlamentin, keni *counter party*-n tuaj tani që edhe mund t'i ftoni në çdo mbledhje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, Altin!

Në fakt, ligjet nuk mund të bëhen në gjuhën e fëmijëve, ka teknikë legislative për to, por të gjitha parlamentet prodhojnë një model të thjeshtë të ligjit në formë broshurash, kryesisht me figura, me forma më të kapshme për fëmijët. Po të vësh re, Këshilli i Europës i ka kthyer të gjitha konventat në formën e një broshure, çka mund të bëhet edhe te ne. Ne kemi shumë organizata të shoqërisë civile, që bashkë me donatorët mund të zërthejnë një ligj, ndërsa ligji është ligj që do të zbatohet nga gjykatat, institucionet, prokuroritë dhe për të gjithë shoqërinë. Neve na mungon pjesa miqësore e përkthimit me një terminologji të thjeshtë me raste praktike, ama mendoj se ka shumë rëndësi kurikula e shkollës, lënda e edukimit ligjor, e cila informon fëmijët.

Matilda Tyli – Do të doja t'ju falënderoja, sepse është hera e dytë që dëgjoj këtë lloj prezantimi dhe iniciativat tuaja janë për t'u vlerësuar!

Ajo që më shqetëson është fakti i vazhdimësisë së punës suaj, pra, pavarësisht se flasim për parlament rinor, për qeveritë e nxënësve, megjithatë kam konstatuar gjatë punës sime, gjithashtu, që këto janë të heshtura dhe të fjetura. Ne vërtet kërkojmë shumë nga

qeveria apo nga institucionet, por, së pari, mendoj se duhet të kërkojmë nga vetja. Pyetja ime është: si do të vazhdoni në të ardhmen? A keni mendime dhe ide dhe çfarë ndihme kërkon ju nga ne?

Faleminderit!

Odea Jakupi – Jam pjesë e Parlamentit Rinor dhe jam nxënëse në vitin e dytë në gjimnazin “Andon Zako Çajupi”.

Pikë së pari, kur ne kërkojmë te vetja, e bëjmë shumë mirë këtë, por sa mbështetje arrijmë të gjejmë! Siç e vutë re edhe te sondazhi, një ndër pjesët më të votuara ishte problematika që të rinjtë kanë humbur shpresën për vendin dhe nuk kanë një perspektivë në të ardhmen. Pra, në qoftë se mesatarisht do të marrësh një të ri nga një cep i Shqipërisë dhe do ta pyesësh se çfarë mendimi ke për të ardhmen tënde, përgjigjja e tij do të jetë që do të ikë jashtë e do të punojë atje.

Ne që kemi ardhur këtu jemi një pjesë shumë e vogël e të rinjve në Shqipëri që kërkojmë shumë nga vetja, por kemi edhe moshatarët tanë që nuk mendojnë që ky vend mund t’ua ofrojë ato gjëra që duan.

Prandaj jo gjithçka varet nga besimi ynë, por duhet të kemi më shumë mbështetjen e organizatave, të qeverisë e të tjerë.

Vasilika Hysi –Shumë faleminderit!

Kam një pyetje për ju: si e kanë krijuar këtë perceptim të rinjtë? Çfarë ka ndikuar në krijimin e perceptimit të tyre?

Odea Jakupi – Mendoj që, në fakt, kjo është pyetje që ne duhet t’jua bëjmë juve, sepse...

Vasilika Hysi –Unë e di si krijohet perceptimi, por ju vet kur nuk keni një përvojë personale, megjithatë keni një perceptim, nga se ndikoheni, nga bisedat në familje, nga mediat, rrjetet sociale?

Odea Jakupi – Ne jemi gjithë kohën në telefon, para ekranit të televizionit dhe tashmë është e qartë përgjigjja e kësaj pyetjeje. Për shembull, në qoftë se shohim parlamentin shqiptar, kemi krijuar një ide që politikanët vetëm dinë të zihen, të përplasen për interesat e tyre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por unë flas për ato që shoh në televizor.

Vasilika Hysi –T’ju bëj një pyetje, e kam për të rinjtë: a ekziston mundësia që Parlamenti Rinor Shqiptar të marrë nismën për të promovuar modelet pozitive të të rinjve në shkolla e në çdo cep të Shqipërisë, sikurse ne po përpiqemi?

Me Altinin ndajmë mendime ndryshe, ai nxjerr vetëm gjëra negative, unë them “model i mirë”, nuk debatoj, megjithëse e kam pasur edhe student, e kam udhëhequr në temë, mendova se si gazetar do të promovonte pozitivitet, por të paktën ju, a mundeni të promovoni modelet tuaja?

Juve do t’ju promovojmë ne, se nuk e bëni dot për veten tuaj. Unë mendoj se kaq të mirë sa jeni, jeni model i mirë për shumë të tjerë që nuk e marrin mundimin të lexojnë dhe thonë se ky vend nuk bëhet.

Matilda Tyli - Në një nga takimet tona të Parlamentit Rinor, një nga idetë që kemi pasur ka qenë pikërisht të bëjmë *use-talks*, “Të rinjtë për të rinjtë”, pra një gjimnaziste të tregojë eksperiencën e saj në një organizatë dhe të informojë një të ri tjetër, që, pse jo, edhe ky i ri t’i bashkohet kësaj organizate; të informojë një të ri për diçka që është e vlefshme dhe ai ta marrë këtë informacion. Kjo ka qenë një ndër pikat që presim ta realizojmë.

Vasilika Hysi – Kanë ndonjë gjë tjetër të rinjtë?

Matilda Tyli – Një ndër nismat që kemi marrë, është “Safe internet champions”, që mendoj se është një ndër gjërat më të mira që kemi bërë deri tani në bashkëpunim me disa organizata dhe një kompani telekomunikacioni. Të gjithë të rinjtë, gjimnazistët që janë iniciatorë të kësaj nisme kanë si qëllim dhe objektiv të përhapin informacion dhe të ndërgjegjësojnë të rinjtë në gjimnaze për të drejtat që ata kanë, abuzimet që nuk duhet t’i bëjnë në internet, pra të gjitha problematikat që ne hasim si buling.

Vasilika Hysi – Ju lutem, desha t’ju bëj një ndërhyrje, pa ju fyer, ne jemi në parlamentin shqiptar, pse përdorni kaq fjalë të huaja?

Matilda Tyli - Sepse nuk e di si mund ta përkthej buling në shqip. Vetë bulizmi nuk është fjalë shqip.

Vasilika Hysi – Nuk e kam fjalën për ju, por analistët për t’u dukur modern dhe sikur dinë shumë gjuhë të huaja, e kanë bastarduar gjuhën shqipe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aurela Pano që është në Amerikë e flet shqipen më mirë se kushdo tjetër.

Nëse nuk keni gjë tjetër unë do të doja t’ju falënderoja edhe në emër të deputetëve.

Besoje se ju e patë se megjithëse ne kishim shumë angazhime ishim të gjithë bashkë. Të gjithë kemi angazhime pasdite, por ju ndoqëm me vëmendje, mbajtëm shënime dhe ju falënderojmë që keni depozituar raportin.

Më vjen mirë që ka përfaqësues institucionesh që merren me të drejtat e fëmijëve dhe do t’ju ftoja të bëni binjakëzimin me komisionet përkatëse. Nuk është e thënë të shpenzoni të gjithë ditën në Kuvend, ne të gjitha projektligjet i kemi në faqen e Kuvendit.

Gjithashtu, nuk është e thënë të njihni ligjin dhe gjuhën patjetër, por në rast se ju shikoni që një projektligj që është në diskutim në Kuvend, që ka të bëjë me jetën e të rinjve, dhe ndikon në jetën e të rinjve ndihuni të lirë të kërkonti të dëgjoheni! Sikurse e patë besoj se u ndiet shumë mirë.

Nga ana tjetër, unë do t'ju vlerësoja shumë, ishit model, me të vërtetë një model shumë i mirë, por unë do të doja që ky model të mos mbetet në arkiv. Të gjitha procesverbalet, pasi qëndrojnë 10 vjet në parlament, shkojnë në Arkivin e Shtetit dhe pas 10 ose 100 vjetësh stërnipërit tuaj mund t'i lexojnë. Prandaj, do t'ju inkurajoja fort të dëgjoheni dhe të bëheni ambasadorë për fëmijët tjerë, në shkollat tuaja.

Nga ana tjetër, do t'u inkurajoja fort t'ju kërkonti llogari kryetarëve të Bashkive këshillave bashkiakë, deputetëve në zonat tuaja. Nuk është e thënë të keni përkatësi politike, ju keni të drejtë të kërkonti. Unë sot në orën 18:00 kam lënë një takim për infrastrukturën në njësinë time me të rinj profesionistë, inxhinierë e të tjerë, do ta moderoj unë dhe do t'i kërkojmë llogari se çfarë është bërë në njësi për një strukturë miqësore për të rinjtë. Këto takime mund t'i kërkonti edhe ju.

Përpara kemi 1 qershorin, do të shohim të bëjmë diçka të dobishme për të rinjtë dhe fëmijët. Jeni të mirëpritur nëse keni ide dhe sugjerime.

Lidhur me nismën ligjore, Altin, do të lutesha nëse keni ndonjë opinion për nismën ligjore nga ju, si CRCA, do t'i vlerësonim. Gjithmonë duhet të nxitemi nga kujdesi për të bërë ndërhyrje, të cilat duhen, sepse përndryshe, në vend që të përmirësojmë, dëmtojmë. Po hyri në fuqi dispozita, nuk pyet më je i mitur ose i ri.

Nga ana tjetër, do të përcjell te Komisioni i Edukimit të gjitha shqetësimet lidhur me kurrikulën. Këtu kemi edhe deputetë që janë në atë komision, gjithashtu, dhe deputeti Roshi, që drejton Komisionin e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, mund të thotë në fjalën e tij përmbyllëse se çfarë mund të bëjnë si komision.

Enver Roshi -Faleminderit!

Natyrisht, kur sheh këta të rinj, më rriten shpresat për të ardhmen e vendit.

Ajo që unë premtoj këtu është se të gjitha problematikat e çështjeve të fëmijëve do të prezantohen në komisionin tonë dhe do t'i mbështesim ato fuqishëm.

Unë veç kësaj pashë te grupi i të rinjve përgjegjësi të madhe për veten e tyre, sepse besimi për të ardhmen fillon te besimi te vetja, te detyrat dhe përgjegjësitë që ka çdo i ri për të bërë ato realizime që ai ka: të mësuarit dhe pjesëmarrja në shoqëri.

Në këtë raport dolën shumë çështje, të cilat ne i morëm shënim dhe në të ardhmen do të kemi një bashkëpunim më të madh me Altinin, drejtoreshën e Agjencisë dhe organizatat e tjera të interesuara për çështjet e fëmijëve.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA